



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

# **RAPORTI VJETOR**

## **2020**

**Prishtinë, 2021**



**RAPORTI VJETOR 2020**



## Përmbajtja

PËRMBAJTJA.....	5
FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE .....	7
FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM .....	9
RAPORTI VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2020.....	10
SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE .....	13
NJËSIA LIGJORE (NJL) .....	17
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ) .....	21
DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE, STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA) .....	31
DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP).....	43
DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF) .....	47
NJËSIA E PROKURIMIT (NJP).....	53
NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE (NJTIKM) .....	57
NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB).....	61
ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI) .....	65
AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE.....	69
SHTOJCA I .....	75
ORGANOGRAMI .....	79



# FJALA HYRËSE E KRYETARES SË GJYKATËS KUSHTETUESE

Viti 2020 ishte një vit sprove për të gjithë qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Ishte një vit i rrethanave dhe kushteve të jashtëzakonshme për punë, por njëherësh edhe i punës intensive dhe të arriturave të reja.

Si rrjedhojë e kufizimeve të imponuara nga situata pandemike (COVID-19) në vend dhe për dallim nga vitet e kaluara, Gjykata Kushtetuese e përmbylli vitin 2020 me më pak aktivitete zyrtare, punëtori dhe vizita studimore, por me numër solid të kërkesave të pranuar dhe të shqyrtuara.

Krahas punës njëvjeçare të secilit departament dhe njësisë organizative të Gjykatës, Raporti vjetor i punës përmban të dhëna më të detajuara statistikore për shpenzimet buxhetore dhe aktivitetet e prokurimit, për konferencat dhe punëtoritë e organizuara, për vizitat e realizuara në vend dhe jashtë vendit, si dhe për numrin e lëndëve të pranuar dhe të shqyrtuara.

Për sa i përket numrit të lëndëve, Gjykata gjatë vitit 2020 ka pranuar 195 kërkesa/lëndë, ndërsa 197 sosh janë bartur nga vitet paraprake. Prej numrit total të kërkesave të parashtruara gjatë vitit 2020, 161 kërkesa janë parashtruar nga individët, ndërsa 34 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet publike. Në ueb-faqen e Gjykatës ndërkaq janë publikuar 183 vendime, prej të cilave 20 ishin aktgjykime dhe 138 aktvendime për papranueshmëri.

Nga të gjitha kërkesat e parashtruara, në të cilat Gjykata gjeti shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dëshiroj të veçoj:

Kërkesën KI56/18, të parashtruar nga Ahmet Frangu, i cili kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, ARJ.UZVP. nr.67/2017. Gjykata vlerësoi se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta, si dhe Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Komuna e Prishtinës, kanë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit, të garantuara me nenet 36 dhe 54 të Kushtetutës, në lidhje me nenet 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), për shkak të mos regjistrimit të vdekjes së birit të tij në Regjistrin Themeltar të të Vdekurve.

Kërkesën tjetër të rëndësishme, që ishte edhe kërkesa me numër të lëndës KI193/18, e parashtruar nga Agron Vula, që kërkoi vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me mos përmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se mos përmbarimi i Aktvendimit të KPMSHCK-së nga Komuna e Gjakovës, sidomos pas disa vendimeve të gjykatave të rregullta që lejuan përmbarimin e tij, ka shkaktuar shkelje të neneve 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.

Përkitazi me kërkesat e parashtruara nga institucionet e autorizuara sipas nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata gjatë vitit 2020 shqyrtoi rastin KO54/20, kërkesë e parashtruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, që kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/15 të 23 marsit 2020. Gjykata konstatoi se, vendimi i kontestuar i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me nenet 55, 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenet 8 dhe 11 të KEDNJ-së, si dhe me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së.

Rast tjetër i rëndësishëm që Gjykata e shqyrtoi përkitazi me kërkesat e parashtruara nga institucionet e autorizuar sipas nenit 113 të Kushtetutës, ishte edhe kërkesa me numër të lëndës KO219/19, parashtruar nga Avokati i Popullit, që kërkonte vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, nr. 06/L-111. Gjykata konstatoi se, ligji i kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 4, 7, 102, 103 (1), 108, 109, 110, 115, 132, 136, 139 dhe 141 nga Kapitulli XII i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për më shumë detaje rreth aktgjyqimeve të tjera me rëndësi, por edhe për aktvendimet dhe vendimet e tjera të nxjerra gjatë vitit 2020, lexuesit mund t'i referohen edhe ueb-faqes zyrtare të Gjykatës Kushtetuese: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org).


Vitin që shkoi, në Gjykatën Kushtetuese u zhvilluan edhe aktivitete të ndryshme që u realizuan në formë të vizitave zyrtare brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrjes në trajnime profesionale, ndonëse shumë prej tyre u zhvilluan në distancë dhe nëpërmjet video-konferencave për shkak të kufizimeve të imponuara nga pandemia COVID-19.

Me përkrahjen e donatorëve ndërkombëtarë, Gjykata gjatë vitit 2020 arriti të iniciojë dhe të realizojë edhe shumë projekte të reja, që për qëllim kanë ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve profesionale dhe teknologjike të institucionit tonë.

Shfrytëzoj rastin që në këtë aspekt, veçanërisht të shpreh falënderimin tim për mbështetjen e ofruar vitin e kaluar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe për hartimin e planit të ri strategjik të Gjykatës.

Për punën e tyre profesionale dhe për kontributin e dhënë në të arriturat e Gjykatës Kushtetuese, një falënderim të veçantë dëshirojë të shpreh edhe për të gjithë gjyqtarët, Sekretarin e përgjithshëm, këshilltarët kushtetues-juridik dhe zyrtarët e tjerë të administratës.

**Arta Rama-Hajrizi**



**Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës**



## **FJALA E SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM**

Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes Raportin vjetor 2020 të punës së Sekretariatit të Gjykatës, mekanizëm ky që mbështet Gjykatën Kushtetuese dhe që siguron funksionimin efikas të administratës së Gjykatës.

Sikurse edhe raportet pararendëse vjetore, ky raport ofron një pasqyrë të aktiviteteve të Gjykatës gjatë vitit të kaluar, me fokus të veçantë në punën dhe në rezultatet e secilit departament dhe të secilës njësi të administratës së Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati ishte i përkushtuar në arritjen e objektivave të punës dhe në përmbylljen me sukses të projekteve të parapara në Planin e punës për vitin 2020, si dhe në implementimin e plotë të Planit Strategjik të Gjykatës për periudhën 2018-2020, përkundër sfidave të krijuara nga pandemia COVID19 gjatë vitit 2020.

Në mënyrë të veçantë, Sekretariati ishte i fokusuar në aftësimin dhe në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale të personelit dhe në zhvillimin, në hartimin e në zbatimin e mëtejme të rregullave dhe të procedurave të punës, për të siguruar një performancë sa më të lartë të Sekretariatit, brenda përgjegjësiave që ka.


Përmbushja e objektivave të identifikuara është fryt i punës ekipore të personelit të Sekretariatit, prandaj, sikurse viteve që shkuan, përfitoj nga rasti t'i shpreh mirënjohje të gjithë personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës, si dhe në sigurimin e funksionimit me efektivitet të lartë të Gjykatës.

Një falënderim i veçantë iu shkon donatorëve, të cilët, edhe në vitin 2020, me asistencën e tyre, ndikuan në arritjen e sukseseve të përgjithshme të Gjykatës.

Veçmas, në emrin tim dhe në emër të stafit të Sekretariatit, falënderoj Kryetaren e Gjykatës, mr. sc. Arta Rama-Hajrizi dhe gjyqtarët për inkurajimin, për përkrahjen dhe për mbështetjen profesionale që na kanë ofruar në tejkalimin e sfidave.

Sekretariati, po ashtu, edhe në vitin 2021, do të mbetet i përkushtuar në zbatimin e Planit të punës dhe Planit Strategjik për periudhën 2021-2025.

**Milot Vokshi**



**Sekretar i Përgjithshëm**

# **RAPORT VJETOR I GJYKATËS KUSHTETUESE PËR VITIN 2020**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Në vitin 2020, Gjykata Kushtetuese pranoi 195 kërkesa të reja.

Nga kërkesat e parashtruara në Gjykatë në vitin 2020, ajo vendosi për 206 kërkesa, ndërsa publikoi në ueb-faqen e Gjykatës dhe ua dorëzoi palëve 190 vendime.


Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese u publikuan në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 16 (3) (i) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës 01/2018, Gjykata Kushtetuese aprovoi raportin e saj vjetor për vitin 2020, në seancën administrative të mbajtur më 1 mars 2021.

Në pajtim me nenin 115.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në pajtim me rregullin 18 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës 01/2018, Sekretariati gjatë vitit 2020 organizoi mbarëvajtjen e 1 (një) seance administrative. Në këtë seancë administrative u morën 3 (tre) vendime.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2020, ishte e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar



**Arta Rama-Hajrizi**  
kryetare



**Bajram Ljatifi**  
zëvendëskryetar



**Bekim Sejdiu**  
gjyqtar



**Selvete Gerxhaliu  
Krasniqi**  
gjyqtare



**Gresa Caka Nimani**  
gjyqtare



**Safet Hoxha**  
gjyqtar



**Remzije Istrefi Peci**  
gjyqtare



**Radomir Laban**  
gjyqtar



**Nexhmi Rexhepi**  
gjyqtar



## SEKRETARIATI I GJYKATËS KUSHTETUESE

Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe në pajtim me rregullin 18 të Rregullores së punës 01/2018, ka kryer punët administrative dhe ka mbështetur punën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili sipas nenit 12.4, është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e Sekretariatit. Struktura organizative e Sekretariatit përbëhet nga:

- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti i Administratës dhe i Burimeve Njerëzore (DABNJ);
- Departamenti për Regjistrim të Lëndëve, Statistikë dhe Arkiv (DRLSA);
- Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP);
- Departamenti për Buxhet dhe Financa (DBF);
- Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI);
- Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB);
- Njësia e Prokurimit (NJP); dhe
- Njësia e Teknologjisë së Informacionit, e Komunikimit dhe e Multimedieve (NJTIKM).

Në realizimin e objektivave të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2018-2020, nga **136** aktivitete të parapara për zhvillim gjatë vitit 2020, **108** prej tyre janë realizuar me sukses.

Funksionimi i Njesisë Ligjore (NJL), e përbërë nga këshilltarët kushtetues-juridikë dhe personeli tjetër ligjor, si dhe struktura dhe organizimi i saj, janë përcaktuar me Rregulloren nr. 03/2019 për Njësine Ligjore. Këshilltarët kushtetues-juridikë mbështesin punën profesionale të gjyqtarëve.

Gjatë vitit 2020, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese ka realizuar këto objektiva:

- Implementimi i Planit Strategjik 2018-2020;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2018-2020;
- Hartimi i Regjistrimit të Rrezikut për vitin 2020.

Gjatë vitit të kaluar, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese gjithashtu publikoi:

- Raportin vjetor të punës për vitin 2019;
- Buletinin informativ nr.9 (korrik-dhjetor 2019);
- Buletinin informativ nr.10 (janar-qershor 2020);
- Buletinin e Praktikës Gjyqësore 2019, në tri gjuhë.



**NJËSIA LIGJORE  
(NJL)**





## NJËSIA LIGJORE (NJL)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese, ka themeluar Njësinë Ligjore (NJL) si një strukturë të veçantë organizative e cila i përgjigjet drejtpërdrejt Kryetarit/es të Gjykatës Kushtetuese dhe kryen detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve.

Roli parësor i Njësisë Ligjore është që të ofrojë mbështetje profesionale për gjyqtarët e Gjykatës në procesin e hartimit të raporteve paraprake; vendimeve përfundimtare të Gjykatës; si dhe, të të gjithë materialit tjetër ligjor që është i nevojshëm për punën e Gjykatës. Në këtë drejtim, Njësia Ligjore është përgjegjëse që të ndihmojë Gjykatën drejt sigurimit të një kualiteti të lartë të vendimmarrjes dhe të konsistencës së praktikës gjyqësore. Për të tilla qëllime, Njësia Ligjore kryen hulumtime shteruese ligjore në nivel të së drejtës kombëtare të Republikës së Kosovës; të drejtës kushtetuese rajonale dhe ndërkombëtare; të drejtës ndërkombëtare dhe asaj krahasuese; opinioneve, rekomandimeve dhe praktikave të mira të shpallura nën ombrellën e Këshillit të Evropës dhe Komisionit të Venecias; praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë; dhe, sipas nevojës, edhe të gjykatave të tjera ndërkombëtare.

Funksionet e tjera të rëndësishme të Njësisë Ligjore janë: (i) takimi me palët dhe asistimi i Sekretariatit në pranimin e kërkesave dhe dokumenteve shtesë; (ii) filtrimi i të gjitha kërkesave të reja të dorëzuara në Gjykatë dhe hartimi i një raporti fillestar filtrues në lidhje me kërkesën e dorëzuar; (iii) identifikimi i kërkesave me masë të përkohshme dhe urgjencave të tjera që një kërkesë mund të paraqet varësisht nga natyra e rastit; (iv) mbajtja dhe përditësimi i bazave të të dhënave siç janë: baza e të dhënave e llojit të kërkesave dhe pretendimeve të ngritura; baza e të dhënave për zbatimin e vendimeve të Gjykatës; baza e të dhënave për përcjelljen e gjendjes së secilit rast që nga fillimi e deri në publikimin e tij. Të gjitha vendimet e Gjykatës filtrohen nga Njësia Ligjore para publikimit në ueb-faqen e Gjykatës me qëllim të ofrimit të mundësisë për një kërkim më të lehtë shkencor, profesional dhe akademik për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe komunitetin juridik.

Njësia Ligjore përbëhet nga: Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik; Juriskonsulti; Zëvendës Këshilltarët e Parë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët e Lartë Kushtetues Juridikë; Këshilltarët Kushtetues Juridikë dhe Këshilltari i Lartë për Administrimin e Kërkesave. Aktualisht, Njësia Ligjore përbëhet nga 14 anëtarë dhe menaxhohet nga Këshilltarja e Parë Kushtetuese Juridike dhe dy zëvendësit e saj. Që të tre, përfshi Juriskonsultin, zgjidhen nga gjyqtarët e Gjykatës nga radha e këshilltarëve të lartë kushtetues juridikë. Këshilltari i Parë Kushtetues Juridik vepron në kapacitet ndërlidhës ndërmjet Kryetarit të Gjykatës dhe Sekretarit të Përgjithshëm dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së Njësisë Ligjore. Ai/Ajo ndihmon dhe këshillon Gjykatën në kryerjen e funksioneve të saj si dhe mbikëqyr dhe mbështetë të gjithë anëtarët e Njësisë Ligjore në kryerjen e detyrave të tyre. Pozicioni i Juriskonsultit është një rol i ri në Njësinë Ligjore i krijuar në vitin 2019. Roli kryesor i tij është që të këshillojë Gjykatën dhe ta njoftojë atë për çështje të ndryshme që ndërlidhen me praktikën gjyqësore të vet Gjykatës me synim të sigurimit të konsistencës së praktikës gjyqësore. Në bashkërendim me Këshilltarin e Parë Kushtetues Juridik, Juriskonsulti ndihmon në procesin e sigurimit të kualitetit të lartë të vendimmarrjes dhe konsistencës së praktikës gjyqësore; dhe, në këtë aspekt, propozon rekomandime përkatëse të cilat kanë për synim konsistencën dhe kualitetin e vendimmarrjes së Gjykatës.

Anëtarët e Njësisë Ligjore kanë role specifike të krijuara për nevojat e Gjykatës. Ata kanë statusin e të punësuarit me kohë të pacaktuar dhe nuk janë shërbyes civil. Kushtet specifike të punës dhe përshkrimet e sakta të detyrave të tyre të punës janë të përcaktuara me Ligjin për Gjykatën, Rregulloren e punës dhe Rregulloren për Njësinë Ligjore. Sa i përket këshillimeve

që ofrojnë, ata janë të pavarur dhe të lirë të shprehin mendimin e tyre profesional në lidhje me çdo kërkesë në të cilën ata punojnë.

Njësia Ligjore mban takime të rregullta për të diskutuar çështje të ndryshme juridiko-kushtetuese, për të përcjellë gjendjen e rasteve, për të rishikuar mundësitë e akteve të brendshme të Gjykatës si dhe mban konsultime rreth praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe GJEDNJ-së. Po ashtu, Njësia Ligjore përgatit materiale të ndryshme për diskutim përgjatë seancave profesionale që mbahen me gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës.

Faktor i rëndësishëm në sigurimin e vendimmarrjes efikase juridike dhe të ngritjes së hartimit të raporteve dhe të vendimeve, është trajnimi i këshilltarëve profesional të Gjykatës në fushën e së drejtës kushtetuese, ndërkombëtare dhe të të drejtave të njeriut. Në kuadër të aktiviteteve të Gjykatës, anëtarët e Njesisë Ligjore marrin pjesë në punëtori profesionale gjatë tërë vitit. Lista e plotë e aktiviteteve të këshilltarëve juridikë mund të gjendet në Pjesën X të këtij raporti (Aktivitetet e Gjykatës).

Përgjatë vitit 2020, përkundër vështirësive të jashtëzakonshme që ka paraqitur pandemia COVID-19, Njësia Ligjore ka arritur që të përmbush të gjitha detyrat e saj drejt ofrimit të mbështetjes së gjyqtarëve në trajtimin e rasteve që janë paraqitur në Gjykatë. Përkundër këtyre vështirësive, puna ka vijuar pa pengesa përmes organizimit të punës me kujdestari në zyre dhe përmes platformës online – varësisht nga rekomandimet e dhëna të ekspertëve të shëndetit publik. Përgjatë këtij viti janë trajtuar një numër i lartë i rasteve në të cilat Njësia Ligjore ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në procesin e analizimit të rasteve, përgatitjes së hulumtimeve ligjore dhe hartimit të vendimeve, bazuar në vendimmarrjen e gjyqtarëve të Gjykatës.

Njësia Ligjore vazhdon të jetë e përkushtuar në ngritjen e profesionalizmit të saj, nëpërmjet realizimit të projekteve të ndryshme, që ofrohen dhe mundësohen nga partnerët strategjikë të Gjykatës Kushtetuese. Në vazhdimësi dhe përgjatë gjithë vitit, Gjykata Kushtetuese është e hapur për të ofruar takime me studentë apo nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, qoftë edhe të formatit online, me qëllim të njoftimit të të gjithë të interesuarit lidhur me punën e Gjykatës Kushtetuese, rolin e saj të përcaktuar me Kushtetutë si dhe kërkesat që paraqiten pranë saj.

**DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE  
NJERËZORE (DABNJ)**



# DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE BURIMEVE NJERËZORE (DABNJ)

## I. Burimet njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

Gjatë vitit 2020, Departamenti i Administratës dhe Burimeve Njerëzore (DABNJ) në zbatim të planit të punës, mbështeti mbarëvajtjen e punës së Sekretarisë përmes shërbimeve të ndryshme. Marrë parasysh që viti 2020 filloi me vonesë të aprovimit të buxhetit për vitin 2020, duke u pasuar me pandeminë globale COVID-19 bëri që puna e DABNJ-së të organizohet bazuar në prioritete dhe domosdoshmëri. Shumica e aktiviteteve të parapara me planet vjetore u prolonguan dhe se puna gjatë 9 muajve të vitit u zhvillua me staf esencjal, kujdestari dhe përmes platformës online.

Gjatë kësaj periudhe, në përputhje me shënimet e personelit u ndërmorën këto aktivitete:

- Organizimi i një (1) konkursi të jashtëm për plotësimin e një (1) pozite: Përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhët: anglisht e serbisht dhe anasjelltas; kandidati i përzgjedhur pritet të fillojë punën më 1 shkurt 2021;
- Organizimi i dy (2) procedurave të avancimit, përmes konkurseve të brendshme për plotësimin e pozitave: Drejtor i Njesisë së Prokurimit, dhe Zyrtar për Trajnime dhe Zhvillim të Karrierës;
- Dy (2) zyrtarë të GJKK-së përfunduan marrëdhënien e punës në GJKK, përkatësisht, një (1) vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës me arritjen e moshës së pensionimit nga pozita Zyrtar për Statistika dhe Përgatitje të Seancave, dhe një (1) vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës sipas dorëheqjes për pozitën Përkthyes i gjuhës Turke;
- Në kuadër të përfundimit të periudhës provuese, tre (3) këshilltar kushtetues juridik dhe një (1) zyrtar i Sekretarisë kaluan me sukses periudhën provuese një vjeçare. Si rrjedhojë janë përditësuar të gjitha kontratat e punës dhe akt-emërimet e stafit të GJKK-së, si dhe në listat e pagave janë përcjellë dhe ekzekutuar nga Ministria e Administratës Publike (MAP) të gjitha ndryshimet brenda vitit;
- Gjashtëmbëdhjetë (16) zyrtarë të GJKK-së mbushën dhjetë (10) vite pune të pandërprerë në Gjykatën Kushtetuese gjatë vitit 2020 dhe të njëjtit u shpërblyen me pagën jubilarë;
- Janë përgatitur dhe ofruar vërtetime të dëshmisë së punësimit sipas kërkesave të zyrtarëve. Në baza të rregullta është evidencuar vijueshmëria e stafit si dhe është bërë përditësimi i evidencës së pushimeve vjetore dhe mjekësore;
- Gjatë këtij viti, për sa i përket pushimeve të veçanta dy (2) zyrtarë të GJKK-së kanë shfrytëzuar pushimin prindëror, me 70% të pagës si dhe një (1) zyrtarë e emëruar në funksion publik vazhdon të ushtrojë të drejtën për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës;
- Sa i përket zbatimit të Planit Strategjik 2018-2020, janë mbajtur dy punëtori. Punëtorja e katërt dhe përmbyllëse për vitin 2019 së bashku me Regjistrin e Rrezikut,

përfshirë periudhën e tremujorit të parë të vitit 2020, si dhe punëtoria e dytë në lidhje me aktivitetet e zhvilluara për periudhën prill-shtator 2020;

- Gjatë kësaj periudhe gjithashtu u zhvilluan dy punëtoria e disa takime me ekspertët e angazhuar në lidhje me Zhvillimin e Strategjisë së re të Gjykatës për periudhën e ardhshme pesëvjeçare 2021-2025;
- Në fund të kësaj periudhe ka përfunduar procesi i vlerësimeve vjetore të performancës për të gjithë personelin kushtetues administrativ;
- Nga numri i përgjithshëm prej 70 (shtatëdhjetë) punëtor të lejuar me buxhetin e vitit 2020, në fund të kësaj periudhe, numri i përgjithshëm i të punësuarve në listën e pagave është 65 veta, prej të cilëve, 34 janë të gjinisë mashkullore, apo 52.3%, ndërsa 31 të gjinisë femërore, gjegjësisht 47.69%, kurse sa i përket përkatësisë nacionale 59 janë shqiptarë (90.77%), 3 serbë (4.62%), 2 boshnjakë (3.08%) dhe 1 malazez (1.54%). Në këtë numër janë përfshirë edhe ish kryetari i GJKK-së si dhe tre zyrtarët e emëruar nga ai sipas ligjit në fuqi.

Figura nr. 1: Numri i të punësuarve sipas përkatësisë nacionale:





Figura nr. 2: Numri i të punësuarve sipas gjinisë:



## II. Ngritja e kapaciteteve (trajnimet dhe zhvillimi i karrierës)

Gjatë vitit 2020 DABNJ hartoi planin e ngritjes së kapaciteteve për stafin kushtetues administrativ, bazuar në identifikimin e nevojave të zyrtarëve nga planet individuale të trajnimeve, si dhe në vazhdimësi është përditësuar dhe janë evidentuar të gjitha aktivitetet e stafit përgjatë këtij viti.

Në vitin 2020, gjithësej u realizuan 25 aktivitete. Si pasojë e gjendjes pandemike me COVID-19 u pamundësua realizimi i planit të trajnimeve dhe se shumica e aktiviteteve në nëntëmujorin e fundit u realizuan përmes platformave online. Në vijim të dhënave në lidhje me aktivitetet e ndërmarra:


- 1 (një) shkëmbim përvoje;
  - 1 (një) aktivitet ndërkombëtar;
  - 3 (tri) aktivitete të ndryshme/ ligjërata;
  - 4 (katër) punëtori në lidhje me Planin Strategjik;
  - 5 (pesë) Konferenca online/forume; dhe
  - 11 (njëmbëdhjetë) trajnime profesionale;
- 
- Më 1 shkurt deri më 31 mars 2020, në kuadër të projektit për shkëmbim përvoje në Gjykatën e Strasburgut për përvetësimin e praktikave të gjyqësisë evropiane dhe zbatimin e tyre në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës, ka përfunduar trajnimin 2 mujor, një këshilltar nga Gjykata;
  - Më 19-21 shkurt 2020, në Tiranë është mbajtur një Aktivitet Ndërkombëtar me temë: “Hapat konkretë për hartimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për periudhën 2020 – 2023”, me dy pjesëmarrës nga ana e Gjykatës;
  - Më 29-30 janar 2020, në Prishtinë, një zyrtar mori pjesë në trajnimin me temën “Kodi Etik, të drejtat dhe përgjegjësitë në Shërbimin Civil”, organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike;
  - Më 5-6 mars 2020, në Prishtinë, një zyrtare mori pjesë në trajnimin me temën “Planifikimi, menaxhimi dhe zhvillimi i Burimeve Njerëzore”, organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP);
  - Më 9-10 mars 2020, në Prishtinë u organizua Punëtorja e katërt e zbatimit të Planit Strategjik 2018-2020, me 18 pjesëmarrës nga ana e Gjykatës;
  - Më 10-11 mars 2020, nga Akademia Diplomatike e Kosovës, është organizuar trajnimi me temën “Protokolli dhe Etika”, në të cilën morën pjesë dy zyrtare nga Gjykata;
  - Më 16-17 prill 2020, mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë është mbajtur trajnimi përmes platformës online me temën “Neni 15 i Konventës për të drejtat e njeriut” me gjithsej 13 pjesëmarrës nga Njësia Ligjore;
  - Më 11 dhe 12 qershor 2020, mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, është mbajtur tryezë e rrumbullakët përmes platformës online me temën “E drejta në gjykim të drejtë” me gjithsej 13 pjesëmarrës nga Njësia Ligjore;

- Më 22 korrik 2020, në bashkëpunim me organizatën “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë” (YIHR KS), në kuadër të projektit “Youth for Justice”, një këshilltar i Gjykatës Kushtetuese ka mbajtur ligjëratë dhe bashkëbisedim me studentë të edicionit të tretë të Shkollës Alternative për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, përkritazi me rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese në raport me institucionet e tjera në kuadër të sistemit të drejtësisë në vend;
- Më 14-15 shtator 2020, u mbajt një takim konsultativ përmes video-konferencës, me ekipin e raportuesve të caktuar nga Komisioni i Venecias lidhur me përgatitjen e opinionit të Komisionit rreth Projektligjit për Tubimet Publike, të kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku mori pjesë Këshilltarja e parë e Gjykatës Kushtetuese;
- Më 1-2 tetor 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me ndihmën e Këshillit të Evropës, organizoi “Punëtorinë e parë në lidhje me Zhvillimin e Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2025”, përmes platformës online, me nga 30 pjesëmarrës.
- Më 8 tetor 2020, u organizua “Punëtoria e dytë në lidhje me zbatimin e Planit Strategjik 2018-2020”, për periudhën raportuese prill-shtator 2020, realizuar me prani fizike në objektin e Gjykatës, me 14 pjesëmarrës;
- Më 8 tetor 2020, u mbajt një video konferencë virtuale nga fusha e financave me temë “Reforma në menaxhimin e Kesh-it dhe ekzekutimin e buxhetit: Plani i rrjedhës së parasë së gatshme për Organizata Buxhetore”, organizuar nga Thesari, në kuadër të Ministrisë së Financave (MEF), me një pjesëmarrës nga Gjykata Kushtetuese;
- Më 14 tetor 2020, në Prishtinë u realizua trajnimi përmes platformës online me temën “Planifikimi strategjik, treguesit e performancës, udhëzimet administrative në fushën e planifikimit buxhetor dhe ndryshimeve buxhetore”; organizuar nga IKAP në bashkëpunim me MEF, në të cilën mori pjesë një zyrtar nga Gjykata;
- Më 15 tetor 2020 u mbajt trajnimi përmes platformës online me temën "Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (BDMS)", organizuar nga IKAP dhe MEF, ku mori pjesë një zyrtar nga Gjykata;
- Më 16-17 tetor 2020, në Prishtinë, është mbajtur forumi me temën: “Seventh Regional Rule of Law Forum for Southeast Europe”, i organizuar nga The AIRE Centre dhe Civil Rights Defenders, me 4 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 12 nëntor 2020, me ndihmën e Këshillit të Evropës, u organizua një diskutim online me ish Juristkonsultin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë z. Early Lawrence, me 14 pjesëmarrës;
- Më 23 nëntor 2020, u organizua Konferenca përmes platformës online, me temën “70 vjet e Konventës sonë”, nga Këshilli i Evropës, me 22 pjesëmarrës nga Gjykata;



- Më 16 nëntor-10 dhjetor 202, në Prishtinë u mbajt trajnimi 10 ditor nga fusha e prokurimit publik, i organizuar nga IKAP, në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik ( KRPP), me një pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 2-4 dhjetor 2020, u mbajt trajnimi përmes platformës online me temën “Mirësjellja dhe Protokolli” organizuar nga Akademia e Drejtësisë, me një pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 3 dhjetor 2020, me ndihmën e European Center dhe Mbretërisë së Bashkuar u mundësua pjesëmarrja në Konferencën përmes platformës online me temën “Drejt praktikës: përdorimi i jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut në nivel vendas, me 14 pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 7 dhjetor 2020, u mbajt trajnimi përmes platformës online me temën “Menaxhimi i keshit” organizuar nga Thesari, me një pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 7-9 dhjetor 2020, u mbajt trajnimi përmes platformës online me temën “Komunikimi Strategjik” organizuar nga Akademia e Drejtësisë, me një pjesëmarrës nga Gjykata;
- Më 18 dhjetor 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me ndihmën e Këshillit të Evropës, organizoi “Punëtorinë e dytë në lidhje me Zhvillimin e Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese për periudhën 2021-2025”, përmes platformës Zoom, me 30 pjesëmarrës nga Gjykata.

*Figura nr. 3: Pjesëmarrja e stafit të Gjykatës Kushtetuese në vizita studimore, konferenca dhe shkolla verore jashtë vendit, konferenca/punëtori brenda dhe jashtë vendit, trajnime brenda dhe jashtë vendit, kurse të gjuhëve të huaja :*



### III. Mbështetja administrative dhe logjistike

- Është bërë mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt i veturave të Gjykatës si dhe përpilimi me kohë i raporteve mujore lidhur me shpenzimin e derivateve;
- Është kryer kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të IT-së, si dhe është bërë regjistrimi i tij në Sistemin e Menaxhimit të Informatave të E-pasurisë;
- Është bërë regjistrimi i 240 faturave në Sistemin Free Balance, pas furnizimit me material shpenzues dhe me pajisje të IT-së, si dhe shërbimeve për nevoja pune të Gjykatës;
- Janë përpiluar një seri shkresash drejtuar institucioneve të ndryshme lidhur me ekzekutimin e kërkesave të ndryshme administrative dhe ofrimin e shërbimeve për nevoja të Gjykatës.

### IV. Biblioteka e Gjykatës (Shërbimet e bibliotekës)

Nga fusha e bibliotekës janë kryer këto aktivitete, përkatësisht është pranuar dhe regjistruar kjo literaturë:

- Ka vazhduar anëtarësimi vjetor i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës (ABEK), përmes së cilit ofrohet qasja në këto burime elektronike: Cambridge Journals Online, Edward Elgar Publishing, IMF-International Monetary Fund, Open Edition Journals, ASTM- Compass;
- Ka vazhduar abonimi vjetor i Gjykatës Kushtetuese në burimet elektronike të Gazetës Universitare të Oksfordit, përmes së cilave ofrohet qasja në këto burime elektronike: Max Planck Encyclopedia of International Law, ORIL - International Human Rights Law, ORIL - International Law in European Courts, Oxford Constitutions of the World;
- Koalicioni Ndërkombëtar i Konsorciumit të Bibliotekave ka mundësuar qasjen pa pagesë në një listë të gjerë të burimeve elektronike, kryesisht të fushës akademike, gjatë periudhës së COVID-19;
- Janë shërbyer gjyqtarët dhe stafi i Gjykatës me literature fizike dhe elektronike, sipas kërkesave së tyre, si dhe janë shkarkuar artikuj të fushës juridike, sipas rëndësisë së tyre;
- Ndërsa sa i përket titujve të rinj, gjatë vitit 2020 Biblioteka e Gjykatës ka pranuar dhe regjistruar, këta tituj:
  - ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, volume 12, issue 2;
  - ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, volume 13;
  - Thomas Jefferson: Law Review, volume 36. Number 1, The “S Word” and Security Council: The Role and Powers of the United Nations Security Council in the Creation of New States, me autorë Qerim Qerimi;
  - Le Conseil constitutionnel, 2010, revistë franceze;
  - Andreas Sajo & Renata Uitz: The constitution in private relations, 2005;
  - Toby Mendel: Liria e Shprehjes, botuar nga Council of Europe, viti 2014;
  - Gea Suumann: 15 years of constitutional review in the supreme court of Estonia, 2009;

- Jeremy McBride: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Procedura Penale;
  - Luan Omari, Aurela Anastasi: E Drejta Kushtetuese, 2010, nga shtëpia botuese ABC;
  - Kadri Kryeziu : E Drejta E Zgjedhjes, 2013, nga shtëpia botuese Vertigo;
  - Kadri Kryeziu : Prizreni, 2013, nga shtëpia botuese Vertigo;
  - Murat Azakli: Constitutional Justice in Asia;
  - Jorg Gerkrath: Les 20 ans de la cour constitutionnelle;
  - ICL Journal: Vienna Journal on International Constitutional Law, volume 14;
  - Covid-19 dhe impakti mbi të Drejtat e Njeriut, 2020, botuar nga AIRE Centre.
- Janë pranuar dhe regjistruar botimet nga Zyra për publikimin e Gazetës Zyrtare me nga tre kopje,
    - Gazeta Zyrtare nr. 01/2020, mars 2020;
    - Gazeta Zyrtare nr. 02/2020, gusht 2020;
    - Gazeta Zyrtare nr. 05/2020, tetor 2020;
    - Gazeta Zyrtare nr. 06/2020, nëntor 2020.
- Në sistemin e katalogimit elektronik “Koha” janë akomoduar gjithsej 23 libra, të cilat janë sistemuar fizikisht sipas numrit përkatës të lëmisë.



**DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE  
STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)**



## DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT TË LËNDËVE STATISTIKËS DHE ARKIVIT (DRLSA)

### Statusi i lëndëve prane Departamentit te Regjistrimit të Lëndëve, Statistikës dhe Arkivit (DRLSA)

Gjatë vitit 2020, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 392 kërkesa/lëndë, nga të cilat 195 janë pranuar gjatë viti 2020 dhe 197 janë bartë nga vitet e kaluara:


- 18 kërkesa të bartura nga viti 2018, prej të cilave 17 janë zgjidhur kurse 1 është në proces;
- 179 kërkesa të bartura nga viti 2019 , prej të cilave 126 janë zgjidhur kurse 53 janë në proces;
- 195 kërkesa janë pranuar në vitin 2020, prej të cilave 63 janë zgjidhur dhe 132 kërkesa janë në proces.

Në total, gjatë vitit 2020 janë zgjidhur 206 kërkesa (52.6%) nga 392 në punë, ndërsa 185 kërkesa ( 47.4%) janë bartur në vitin 2021.

Gjatë kësaj periudhe, 183 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë përcjellë te palët, ndërsa 23 të tjera të zgjidhura janë në proces të përgatitjes.

Gjatë periudhës në fjalë mesatarisht janë pranuar nga 16.2 kërkesa në muaj kurse janë zgjidhur 17,4. Dinamika mujore e kërkesave të pranuar dhe të zgjidhura është si në vijim:

Grafikoni nr. 1 : Dinamika e kërkesave sipas muajve (01 janar – 31 dhjetor 2020)



## Parashtrimi i kërkesave

Juridiksioni dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është i përcaktuar me Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Besimi i qytetarëve në Gjykatën Kushtetuese është rritur dukshëm si rezultat i punës efikase, efektive dhe të paanshme. Departamenti për regjistrimin e lëndëve, Statistikës dhe Arkivit gjatë vitit 2020 i ka pranuar 195 kërkesa të reja.

Struktura e kërkesave të parashtruara është:

- 161 kërkesa kanë qenë individuale (nga personat fizikë), ose 82,56%, kurse
- 34 kërkesa nga Autoritet e tjera publike (personat juridikë), ose 17,44%.

## Shpërndarja e kërkesave

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, DRLSA i ka proceduar të gjitha kërkesat e parashtruara sipas nenit 13 të Kushtetutës.

Shpërndarja e kërkesave/lëndëve për Gjyqtarët raportues është bërë në përputhje me rregullin 8 dhe 34 të Rregullores së punës së Gjykatës. Përjashtim nga ky rregull është shpërndarja e kërkesave për vënien e masës së përkohshme, të cilat kërkesa procedohen sipas rregullit 55 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, dhe rasteve *ad hoc*, të cilat paraqesin konflikt interesi, në përputhje me nenin 18 të Ligjit për Gjykatat dhe në pajtim me rregullin 7 të Rregullores së punës.

## Qasja në Gjykatë dhe besimi i publikut në punën e Gjykatës


Të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike, fetare apo gjinore, kanë qasje të barabartë në Gjykatën Kushtetuese.

Qasja etnike e individëve tregohet më sa vijon:

- 142 kërkesa nga shqiptarët, ose 72,8 %;
- 14 kërkesa nga komuniteti serb, ose 7,2 %;
- 6 kërkesa nga nacionalitetet e tjera, ose 3,1 %; dhe
- 33 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (personat juridikë), ose 16,9%.




Grafikoni nr. 2 Struktura Etnike e parashtruesve të kërkesave ( 01 janar – 31 dhjetor 2020)



Struktura gjinore e parashtruesve të kërkesave tregohet me sa vijon:

- 136 kërkesa të parashtruara nga gjinia mashkullore , ose 69,7%;
- 22 kërkesa të parashtruara nga gjinia femërore, ose 11,3%;


Grafikoni nr. 3 Struktura gjinore e parashtruesve të kërkesave ( 01 janar– 31 dhjetor 2020)



Përqindja e parashtruesve të kërkesave, sipas grupeve, organizatave punuese dhe Institucioneve:

- 10 kërkesa të parashtruara në grup, ose 5,1%;
- 15 kërkesa të parashtruara nga organizatat punuese, ose 7,7%; dhe
- 12 kërkesa të parashtruara nga institucionet, ose 6,2%.

Grafikoni nr. 4 Përqindja e parashtrësive grupore, organizatave punuese dhe Institucioneve




### Llojet e shkeljeve të supozuara

Tipologjia e shkeljeve të supozuara nga 195 kërkesat e pranuar gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2020, është si në vijim:

- Neni 21 [ Parimet e Përgjithshme), 3 raste ose 1,2%;
- Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] 1 rast ose 0.9%
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 16 raste ose 6,6 %;
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]\_4 raste ose1,6%
- Neni 24 [Barazia para Ligjit], 59 raste ose 24,3 %;
- Neni 31 [ E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 89 raste ose 36,6%;
- Neni 32 [E drejta për Mjete Juridike] \_4 raste ose 1,6%
- Neni 46 [Mbrojtja e Pronës], 18 raste ose 7,4%;
- Neni 49 [E drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 8 raste ose 3,3%;
- Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave],13 raste ose5,3%;
- Neni 84 [Kompetencat e Presidentit] 2 raste ose 1.9%
- Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë] 1 rast ose 0.9%
- Neni 35 [Liria e Lëvizjes] 1 rast ose 0.9%
- Neni 83 [Statusi i Presidentit] 1 rast ose 0.9%
- Neni 145 [ Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm] 1 rast ose 0.9%
- Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] 1 rast ose 0.9% dhe
- Shkelje të tjera, 26 raste ose 10,7 %.


Grafikoni nr. 5 Tipologjia e shkeljeve të supozuara të neneve të Gjykatës Kushtetuese (01 janar – 31 dhjetor 2020)



## Autoritetet e supozuara të shkëljes së të drejtave

- 159 kërkesa ose 81,5 % e tyre kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 36 kërkesa ose 18,5 % e kërkesave kanë të bëjnë me autoritete të tjera publike.

Grafikoni nr. 6 Shkelsit e supozuar të së drejtave (01 janar – 31 dhjetor 2020)




## Afati i zgjidhjes së kërkesave

Gjatë vitit 2020, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 183 vendime.

Grafikoni në vijim pasqyron dinamikën e afatit të zgjidhjes së kërkesave në muaj dhe ditë.

Grafikoni nr. 7 Afati i zgjedhjes së kërkesave (01 janar – 31 dhjetor 2020)



## Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë vitit 2020, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 42 seanca plenare, me 217 kolegje shqyrtuese dhe 2 seanca publike.

Rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime, vendime për hedhje poshtë të kërkesës dhe vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër. Në këtë periudhë kemi edhe 1 mendim mospajtues (në Aktgjykimin KO61/20).

Struktura e 183 vendimeve të publikuara, është si në vijim :

- 20 Aktgjykime;
- 138 Aktvendime për papranueshmëri;
- 21 Refuzim i kërkesës me procedurë të shkurtër;
- 2 Vendime për tërheqjen e kërkesës nga lista;
- 1 Vendim për masë të përkohshme; dhe
- 1 Vendim për vazhdimin e masës së përkohshme.

Grafikoni nr. 8 Struktura e vendimeve të publikuara (01 janar – 31 dhjetor 2020)



Në vitin 2020, Gjykata Kushtetuese ka publikuar 20 aktgjykime:

- Aktgjykim në rastin KI14/18, parashtrues Hysen Kamberi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML.nr.241/2017, të 5 dhjetorit 2017;
- Aktgjykim në rastin KI07/18, parashtrues “Çeliku Rollers” sh.p.k. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 14/2017, të 14 shtatorit 2017 ;

- Aktgjykim në rastin KI35/18, “Bayerische Versicherungsverband”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës E.Rev.nr.18/2017, të 4 dhjetorit 2017;
- Aktgjykim në rastin KO54/20, parashtrues Presidenti i Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 23 marsit 2020;
- Aktgjykim në rastin KO61/20, parashtrues Uran Ismaili dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit [nr. 214/IV/2020] të 12 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për shpalljen e Komunës së Prizrenit “zonë karantinë”; dhe Vendimeve [nr. 229/IV/2020], [nr. 238/IV/2020], [nr. 239/IV/2020] të 14 prillit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin, luftimin dhe eliminimin e sëmundjes ngjitëse COVID-19 në territorin e Komunave të Prizrenit, Dragashit dhe Istogut;
- Aktgjykim në rastin KI193/18, parashtrues Agron Vula. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 227/18, të 18 shtatorit 2018, lidhur me mos përmbarimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, A 02 158/07, të 25 shkurtit 2008;
- Aktgjykim në rastin KO72/20, parashtrues Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. 24/2020, të datës 30 prill 2020;
- Aktgjykim në rastin KI123/19, parashtrues “SUVA Rechtsabteilung”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr.146/17, të 26 shkurtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KO203/19, parashtrues Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik;
- Aktgjykim në rastin KO219/19, parashtrues Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik;
- Aktgjykim në rastin KI56/18, parashtrues Ahmet Frangu. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP.nr.67/2017, të 22 dhjetorit 2017;
- Aktgjykim në rastin KI38/19, parashtrues Avdi Mujaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Rev. nr. 285/2018, të 1 tetorit 2018;
- Aktgjykim në rastin KI214/19, parashtrues Murteza Koka. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 195/2019, të 23 korrikut 2019;
- Aktgjykim në rastin KI27/20, parashtrues Lëvizja VETËVENDOSJE. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [A.A-U.ZH.nr.16.2019] i 10 tetorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës;
- Aktgjykim në rastin KI209/19, parashtrues Memli Krasniqi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ka. Nr.664/2019, të 5 gushtit 2019;

- Aktgjykim në rastin KI80/19, parashtrues Radomir Dimitrijević. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-18-0547-A0001, të 21 shkurtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI227/19, parashtrues N.T. “Spahia Petrol”. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ.UZVP.nr. 94/2019, të 1 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues Et-hem Bokshi dhe të Tjerët. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-13-0181-A0008, të 29 gushtit 2019;
- Aktgjykim në rastin KI224/19, parashtrues Islam Krasniqi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-19-0114, të 19 shtatorit 2019 për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Aktgjykim në rastin KI193/19, parashtrues Salih Mekaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 36/2019, të 5 qershorit 2019.





**DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)**



## **DEPARTAMENTI I PËRKRAHJES PROFESIONALE (DPP)**

Departamenti i Përkrahjes Profesionale (DPP) është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të përkthimit, të redaktimit, të lekturës dhe të harmonizimit të terminologjisë në të gjitha dokumentet e Gjykatës Kushtetuese në gjuhët në të cilat punon GJKK-ja.

DPP-ja ka organizuar, ka udhëhequr dhe ka mbikëqyrur punën e përkthimit (në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze e për ueb-faqen zyrtare të Gjykatës edhe në gjuhën turke), të redaktimit e të lekturës (në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe) dhe të përkthimit aty për aty (simultan). Kështu, nëpër DPP kanë kaluar 27760 faqe të shkresave, të dokumenteve të ndryshme, të aktgjykimeve, të aktvendimeve, të vendimeve për heqje nga lista, të raporteve paraprake e të tjera në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe, në gjuhën angleze dhe në gjuhën turke.

Përkthyesit kanë bërë 177 orë përkthime simultane në takime të rregullta, në seanca të Gjykatës, në seanca administrative, në intervista të kandidatëve për pozitat e shpallura nga GJKK-ja, si dhe në takime të tjera.

Në bashkërenditje me DRLSA-në, DPP-ja ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për takimet e gjyqtarëve dhe për seancat shqyrtuese e administrative.

DPP-ja ka bërë procedimin e lëndëve në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe dhe në gjuhën angleze. Njëkohësisht, ka kontribuar në publikimin e vendimeve në gjuhën shqipe, në serbisht, në anglisht dhe në turqisht.

### **Objektivat**

Objektivat që ka arritur DPP-ja janë këto:

- Standardizimi i të gjitha dokumenteve zyrtare dhe i të gjitha vendimeve që mbajnë vulën e Gjykatës Kushtetuese;
- Eliminimi i mospërputhjeve në aktgjykime, në aktvendime, në raporte paraprake e në dokumente të tjera të Gjykatës;
- Nxitja në përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe organizative për të vënë në praktikë menaxhimin dhe planifikimin me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe për të ngritur bashkëpunimin ndërmjet departamenteve;
- Bashkëpunimi me operatorin ekonomik, sa i përket përkthimit (jashtë Gjykatës dhe në Gjykatë); dhe
- Jetësimi me sukses i të gjitha objektivave që dolën për vitin 2020 nga Plani Strategjik i GJKK-së, 2018-2020.



**DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF)**



## DEPARTAMENTI I BUXHETIT DHE FINANCAVE (DBF)

Gjate viti 2020 Departamenti i Buxhetit dhe Financave (DBF) ka menaxhuar mjetet financiare për Gjykatën Kushtetuese. Mjetet e ndara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Gjykatën Kushtetuese të aprovuara për vitin 2020 sipas Ligjit Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës janë **1,835,354.00€**.

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencio ne dhe transfere	Gjithsej
<b>1,172,237.00€</b>	<b>391,117.00€</b>	<b>4,000.00€</b>	<b>268,000.00€</b>	<b>0.00€</b>	<b>1,835,354.00€</b>

Pas aprovimit të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 07/L-014 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxhetit të Gjykatës Kushtetuese i është shkurtuar buxheti në kategoritë ekonomike si Mallra dhe Shërbime (25,000€) , Shpenzime Komunale (1,000€) si dhe në Investime Kapitale (40,732€).

Buxheti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pas rishikimit paraqitet si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencio ne dhe transfere	Gjithsej
<b>1,172,237.00€</b>	<b>366,117.00€</b>	<b>3,000.00€</b>	<b>227,268.00€</b>	<b>0.00€</b>	<b>1,768,622.00€</b>

Më 26 tetor 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka bërë kërkesë me Nr. ref. SP-1826/20/mv tek Ministria e Financave për ndryshimin e buxhetit, ku është kërkuar nga kategoria e investimeve kapitale (30) me kod 15556 në shumë prej 11,972.00€ si dhe nga kategoria ekonomike shërbime komunale (14) në shumë prej 447.00€ të transferohen/rialokohen mjetet në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime (13) në shumë totale prej 12,419.00€, dhe me këtë rast është bërë harmonizimi/ndryshimi i buxhetit ekzistues.

Më 4 nëntor 2020, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës ka pranuar nga Ministria e Financave shkresën me Nr. ref. MF-1992 “Përmbyllja e vitit fiskal 2020, dhe kursimet e mundshme nga Organizatat Buxhetore në të gjitha kategoritë e shpenzimeve”, dhe me këtë rast Gjykata Kushtetuese për vitin fiskal 2020 nuk ka pas mjete të lira për të kursyer, por ka kërkuar (nr.ref.SP -1895/20/mv) nga Ministria e Financave sa i përket rregullimit të buxhetit që të alokohen mjetet në kategorinë Paga dhe Mëditje (kodi 111), me qëllim të mbulimit deficitit të pagave për gjithë Gjykatën për muajin dhjetor 2020.

Buxheti përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës pas ndryshimeve i paraqitur në SIMFK për vitin 2020, nga Buxheti i Kosovës paraqitet si në vijim:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime Kapitale	Subvencio ne dhe transfere	Gjithsej
<b>1,290,540.94€</b>	<b>378,570.00€</b>	<b>2,552.90€</b>	<b>215,296.00€</b>	<b>0.00€</b>	<b>1,886,960.00€</b>

**BUXHETI I APROVUAR 2020, ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIUdhËN  
JANAR - DHJETOR**

**Alokimet e mjeteve nga buxheti i Kosovës sipas rrjedhjes së parasë për periudhën  
Janar – Dhjetor 2020**

Në buxhetin e përgjithshëm, pjesëmarrja e alokimit për vitin fiskal 2020 ka qenë 378,536.00€ e shprehur në përqindje 100 %.

	Buxheti i aprovuar 2020 (A) €	Alokimet janar- dhjetor (B) €	Realizimet Janar-dhjetor (C) €	% (C/A) €	% (C/B) €
Paga dhe mëditje	1,290,540.94	1,290,540.94	1,290,540.94	100	100
Mallra dhe shërbime	378,536.00	378,536.00	378,504.67	99.99	99.99
Shpenzime komunale	2,552.90	2,552.90	2,463.72	96.50	96.50
Subvencione dhe transfere	0,00	0,00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	215,296.00	215,296.00	215,296.00	100	100
Donacionet	0,00	0,00	0,00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>1,886,925.84</b>	<b>1,886,925.84</b>	<b>1,886,805.33</b>	<b>99.99</b>	<b>99.99</b>

**Realizimi i buxhetit për periudhën janar – dhjetor 2020**

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit për vitin fiskal 2020 ka qenë 1,886,805.33 € e shprehur në përqindje 99.99%.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

	Janar-Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	969,812.53	105,590.28	107,671.23	107,466.90	1,290,540.94	100
Mallra dhe shërbime	320,837.74	15,093.09	27,512.09	15,093.08	378,536.00	100
Shpenzime komunale	2,499.95	-280.35	166.65	166.65	2,552.90	100
Subvencione dhe transfere	0.00	0,00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	227,268.00	0.00	0.00	0.00	215,296.00	100
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>1,520,418.22</b>	<b>108,431.02</b>	<b>135,349.97</b>	<b>122,726.63</b>	<b>1,886,925.84</b>	<b>100</b>



	Alokimet janar – dhjetor (A) €	Realizimi janar – dhjetor (B) €	Mbetja e mjeteve (C) €	% (B/A) €
Paga dhe mëditje	1,290,540.94	1,290,540.94	0.00	100
Mallra dhe shërbime	378,536.00	378,504.67	31.33	99.99
Shpenzime komunale	2,552.90	2,463.72	89.18	96.50
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	215,296.00	215,296.00	0.00	100
Donacionet	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Gjithsej</b>	<b>1,886,925.84</b>	<b>1,886,805.33</b>	<b>120.51</b>	<b>99.99</b>

### Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje janar-dhjetor 2020

Realizimi i pagave dhe mëditjeve sipas muajve:

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti	Realizimi	Mbetja
Janar	67	108,752.97	108,752.97	0.00
Shkurt	67	107,467.00	107,467.00	0.00
Mars	67	107,479.66	107,479.66	0.00
Prill	66	107,925.65	107,925.65	0.00
Maj	66	107,413.77	107,413.77	0.00
Qershor	66	109,931.39	109,931.39	0.00
Korrik	66	107,413.77	107,413.77	0.00
Gusht	66	106,372.54	106,372.54	0.00
Shtator	66	107,055.78	107,055.78	0.00
Tetor	65	105,590.28	105,590.28	0.00
Nëntor	65	107,671.23	107,671.23	0.00
Dhjetor	65	107,466.90	107,466.90	0.00
<b>Gjithsej</b>		<b>1,290,540.94</b>	<b>1,290,540.94</b>	<b>0.00</b>

### Realizimi i buxhetit për mallra dhe shërbime janar-dhjetor 2020

Realizimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2020 të ndara sipas muajve:

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	40,975.17	40,975.17	40,029.35	945.82
Shkurt	40,975.17	40,975.17	39,739.94	1,235.22
Mars	40,975.17	40,975.17	55,494.89	-14,519.72
Prill	24,211.00	24,211.00	34,317.91	-10,106.91
Maj	24,211.00	24,211.00	9,799.82	14,411.18
Qershor	44,211.00	44,211.00	24,570.98	19,640.02
Korrik	25,093.05	25,093.05	54,995.82	-29,902.74
Gusht	55,093.08	55,093.08	48,118.23	6,974.85

Shtator	25,093.08	25,093.08	6,747.76	18,345.32
Tetor	15,093.09	15,093.09	42,063.87	-26,970.78
Nëntor	27,512.09	27,512.09	15,901.24	11,610.85
Dhjetor	15,093.08	15,093.08	6,724.86	8,368.22
<b>Gjithsej</b>	<b>378,536.00</b>	<b>378,536.00</b>	<b>378,504.67</b>	<b>31.33</b>

### Buxheti i ndarë për investime kapitale sipas kodeve të projekteve

Projektet	Kodet e projekteve	Buxheti i aprovuar €	Realizimi €	Mbetja €
Mbindërtimi në objektin ekzistues të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës	15556	215,296.00	215,296.00	0.00
<b>Gjithsej:</b>		<b>215,296.00</b>	<b>215,296.00</b>	<b>0.00</b>

### Realizimi i buxhetit për shpenzime komunale janar-dhjetor 2020

Realizimi i buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunale për vitin 2020 të ndara sipas muajve:<sup>1</sup>

Muaji	Buxheti	Alokimi	Realizimi	Mbetja
Janar	333.34	333.34	205.77	127.56
Shkurt	333.33	333.33	201.04	132.29
Mars	333.33	333.33	201.03	132.30
Prill	333.33	333.33	216.86	116.47
Maj	333.33	333.33	197.83	135.50
Qershor	333.34	333.34	199.04	134.30
Korrik	166.65	166.65	202.45	-35.80
Gusht	166.65	166.65	202.03	-35.38
Shtator	166.65	166.65	201.01	-34.36
Tetor	-280.35	-280.35	207.76	-488.11
Nëntor	166.65	166.65	205.80	-39.15
Dhjetor	166.65	166.65	223.10	-56.45
<b>Gjithsej</b>	<b>2,552.90</b>	<b>2,552.90</b>	<b>2,463.72</b>	<b>89.18</b>

<sup>1</sup> Shpenzimet e komunalive nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet e rrymës, ndersa shpenzimet e largimit të mbeturinave i mbulon Ministria e Administratës Publike.

**NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)**



## NJËSIA E PROKURIMIT (NJP)

Në mbështetje të planit të prokurimit për vitin 2020, Njësia e Prokurimit (NJP) ka iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) aktivitete të prokurimit dhe janë nënshkruar 22 (njëzet e dy) kontrata (tri procedura të ndara në 2 Lote ).

Bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik, aktivitetet e prokurimit i kemi klasifikuar sipas tipit, vlerës dhe procedurës dhe në vijim i paraqesim në detaje:

- a. Procedurë me vlerë minimale (deri 1000 euro)**
- b. Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)**
- c. Procedurë e hapur (vlerë e mesme)**
- d. Procedurë e hapur ( vlerë e madhe)**

### **a) Procedurë me vlerë minimale**

Gjatë vitit 2020 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 9 (nëntë) aktivitete dhe janë nënshkruar 9 (nëntë) kontrata.

1. Vendosja e perdeve rrole dhe perdeve veneciane në zyrat e reja në objektin e mbi-ndërtuar të GJKK-së;
2. Shërbime të mbikëqyrjes dhe konsulencës profesionale;
3. Furnizim me pajisje të imta të TI-së;
4. Shërbime të sigurimit kasko në EU, TPL dhe TPL+ për tri vetura zyrtare;
5. Furnizimi dhe riparimi i pelerinave (mantele) të gjyqtareve të GJKK-së;
6. Furnizimi dhe instalimi i kamerave të sigurisë;
7. Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensorit në objektin e GJKK-së;
8. Projekti ideor për renovimin e gjykatores;
9. Furnizim me ndarëse për seanca dhe huazimi i ndriçimit.

### **b) Procedurë e kuotimit të çmimeve (vlerë e vogël)**

Gjatë vitit 2020 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 3 (tre) aktivitete dhe janë nënshkruar 3 (tri) kontrata.

1. Furnizim me tonerë;
2. Furnizimi dhe instalimi i detektorëve të alarmit kundër zjarrit;
3. Marrje në shfrytëzim të pajisjeve me sensor për spërkatje të duarve me dezinfektues, tunelit dezinfektues dhe shërbimet e dezinfektimit gjeneral të objektit.

### **c) Procedurë e hapur (vlerë e mesme)**

Gjatë vitit 2020 janë iniciuar dhe zhvilluar gjithsejtë 6 (gjashtë) aktivitete, dy prej tyre të ndarë në dy Lote dhe janë nënshkruar 8 (tetë) kontrata, në vijim paraqesim:

1. Punët shtesë për projektin mbi-ndërtimi në objektin ekzistues të GJKK-së;
2. Dizajnimi i interiorit dhe furnizimi me inventar në zyrën e kryetares;
3. Blerja e Laptop PC , UPS dhe LED TV;
4. Servisimi dhe mirëmbajtja i sistemit të serverëve - LOT 1 dhe servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të TI-së - Lot 2;

5. Servisimi dhe mirëmbajtja e automjetit Mercedes C - Lot 1 dhe servisiimi dhe mirëmbajtja e automjetit Peugeot 308 - Lot 2;
6. Shërbime te mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave dhe Objekteve të GJKK-së.

#### **d) Procedure e hapur ( vlerë e madhe )**

Gjatë vitit 2020 është iniciuar dhe zhvilluar gjithsej 1 (një) aktivitet i ndarë në dy Lote dhe janë nënshkruar 2 (dy) kontrata, në vijim paraqesim:

1. Shërbime të përkthimit me shkrim dhe me gojë, nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, në gjuhën serbe, në gjuhë të tjera sipas nevojës dhe anasjelltas, për nevojat e GJKK-së, Lot I dhe II.

Pasqyrimi në tabelë i të gjitha pagesave të realizuara gjatë vitit 2020 si dhe furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara.

Pagesat e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për kontratat e nënshkruara në vitin 2020	Shuma e përgjithshme e pagesave gjatë vitit 2020
Shuma e kontratave, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	62,363.30€
Shuma e paguar për kontrata	84,491.62€
<b>Shuma e përgjithshme</b>	<b>146,854.92€</b>

**NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE (NJTIKM)**





# NJËSIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT KOMUNIKIMIT DHE MULTIMEDIEVE (NJTIKM)

Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Komunikimit dhe Multitmedia (NJTIKM), përgjegjës për ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesjen profesionale në infrastrukturën e përgjithshme të teknologjisë informative në Gjykatë Kushtetuese.

Gjatë vitit 2020, Njësia TIK dhe Multimedia ka realizuar projektet dhe detyrat sipas planit dhe përgjegjësive të saj, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm dhe profesional me pajisje të avancuara teknologjike, në përputhje me planin e punës dhe planit strategjik të Gjykatës Kushtetuese.

## Projektet e realizuara

- Duke u bazuar në gjendjen e krijuar në vend nga virusi COVID-19, gjatë vitit 2020, Gjykata ka marrë vendim që seancat e rregullta të vazhdojnë përmes platformave online. Njësia TIK është angazhuar që të ofrojë përkrahjen me platforma të tjera të teknologjisë që të mundësohet realizimi i detyrave dhe përgjegjësive për stafin e Gjykatës. Është siguruar licenca për platformën Zoom për mbajtjen e seancave online, duke menaxhuar dhe konfiguruar seancat online sipas orarit të përcaktuar nga kabineti, gjithsej 69 seanca online janë mbajtur gjatë vitit 2020;
- Realizimi i projektit Virtual Private Network (VPN), për lehtësimin e punës për stafin e Gjykatës që të punojnë në sistemet e brendshme nga shtëpia. Projekti është financuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me kompaninë e angazhuar për furnizim dhe konfigurim të pajisjeve;
- Përgatitja dhe konfigurimi i pajisjeve në gjykatore për mbajtjen e seancës online për Seancën dëgjimore publike në rastin KO95/20 – e mbajtur më 02.12.2020;
- Përfundimi dhe instalimi i versionit të fundit CDMS me ndryshimet e fundit sipas kërkesës nga përdoruesit, është mbajtur trajnimi për të gjithë gjyqtaret për përdorimin e ndryshimeve të fundit;
- Konfigurimi dhe instalimi i konzolës të Antivirusit (Sophos) në serverët e Gjykatës dhe aplikimi i përditësimeve të reja të Microsoft-it për të gjithë kompjuterët;
- Gjatë vitit 2020 janë iniciuar gjithsej 7 procese të prokurimit për blerjen e pajisjeve të ndryshme të TI-së, softuer dhe pjesë përcjellëse sipas planit të paraparë për këtë vit.

## Aktivitetet e ndërmarra

- Menaxhimin dhe organizimin e detyrave teknike dhe operative brenda Njesisë TIK duke ofruar përkrahjen e nevojshme për funksionalizimin sa më të mirë të pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe sistemeve brenda Gjykatës;
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e sistemit të domenit të Gjykatës dhe krijimi i politikave të sigurisë në serverët e Gjykatës;
- Monitorimi dhe kontrollimi i sigurisë së rrjetës brenda Gjykatës dhe përditësimin e versioneve të reja (update) për të gjitha pajisjet duke i aprovuar dhe instaluar nga Administratori i Sistemit;

- Avancim në ngritjen e sistemeve operative në Windows 10 dhe softuerët e tjerë aplikativ;
- Montimi, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve të ri dhe regjistrimi në domenin e GJKK-së, transferimi i të dhënave;
- Është bërë furnizimi me kablllo, kanale dhe pajisje të tjera përcjellëse për lidhjen dhe instalimin e kompjuterëve ne zyrat e ndërtuara ne objektin shtesë;
- Përkujdesja dhe mbarëvajtja e pajisjeve të zërimit dhe sistemit të përkthimit në gjykatore gjatë mbajtjes së seancave;
- Gjatë vitit 2020 janë publikuar 190 vendime në Ueb Faqe në tri gjuhët zyrtare dhe kategorizimi i tyre në bazë të listës së filtrimit;
- Publikimi i videove në ueb faqe, 10-vjetori i Gjykatës Kushtetuese;
- Përkujdesja dhe ofrimi i shërbimeve për mbarëvajtjen e sistemeve dhe pajisjeve të Teknologjisë Informative dhe komunikimit;
- Përkujdesje në krijimin e kopjeve (back-up) të bazës së të dhënave.

**NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)**



## **NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM (NJAB)**

Bazuar në planin vjetor për vitin 2020, Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) ka përfunduar me kohë të gjitha auditimet e planifikuara, si:

- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve gjatë vitit 2019;
- Menaxhimi i personelit;
- Menaxhimi i shpenzimeve në GJKK;
- Menaxhimi i arkivës;
- Menaxhimi i prokurimit.

Si dhe ka hartuar dhe ka dorëzuar brenda afatit të caktuar:

- Planin Strategjik të AB për periudhën 2021-2023; dhe
- Planin Vjetor të AB për vitin 2021.

Të gjitha auditimet e brendshme janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të objektivave të institucionit dhe të NJAB që kanë të bëjnë me kontrollin e brendshëm dhe me përmirësimin e efikasitetit në punë, me shmangien e gabimeve të mundshme, me rritjen e vlerës dhe me raportimin e parregullsive dhe gabimeve me qëllim të shtimit të kontrollit që të ofrojë siguri tek menaxhmenti për funksionim efikas në departamentet përkatëse.

Në vazhdimësi janë bërë vizita përcjellëse për efikasitetin e sistemeve të menaxhimit dhe të funksionimit të kontrollit të brendshëm, si dhe të zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i Brendshëm dhe nga Auditori i Përgjithshëm.

Menaxhmenti ka vlerësuar punën e auditorëve dhe është kujdesur për implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga auditori i brendshëm, gjithashtu edhe nga auditorët e përgjithshëm, e kjo ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së aktiviteteve dhe performancës së institucionit.

Edhe pse gjendje e jashtëzakonshme (pandemia), NJAB ka realizuar planin për vitin 2020 dhe ka bërë përcjelljen për zbatimin e rekomandimeve.

### **1. Komiteti i Auditimit të Brendshëm**

Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB)- organ i pavarur këshillëdhënës - në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, funksionon bazuar në:

- Udhëzimin Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e Sektorit Publik;
- Statutin e KAB;
- Praktikat e mira; dhe
- Standardet ndërkombëtare të auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2020 ka mbajtur 4 takime dhe siguron mbikëqyrje të planeve, raporteve dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna nga auditorët.

## **2. Auditimi i Jashtëm**

Më 17 qershor 2020, është pranuar raporti i Auditimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Raporti prezanton Opinion të pamodifikuar të Auditorit të Përgjithshëm, ku theksohet se Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik.

Në vitin 2019 GJKK ka shpenzuar pothuajse 100% të buxhetit final dhe se nga të gjitha mostrat e testuara nuk është gjetur asnjë gjetje dhe nuk është dhënë asnjë rekomandim për menaxhmentin e Gjykatës Kushtetuese.

**ZYRA PER KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)**





# ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM (ZKI)

Zyra për Komunikim dhe Informim (ZKI) në fushën e përgjegjësisë të saj përfshinë: informimin dhe komunikimin me mediat/publikun; monitorimin e mediave; publikimin e njoftimeve në ueb-faqen e Gjykatës përkitazi me vizitat/aktivitetet dhe seancat/vendimet; publikimin e Buletinit Informativ të Gjykatës; publikimin e Librit të Gjykatës dhe të fletushkave/broshurave të tjera informative; komunikimin me palët/qytetarët; protokollin; kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës dhe mbrojtjen e të dhënave personale; si dhe bashkëpunimin me Komisionin e Venecias.

Gjatë vitit 2020, në Zyrën për Komunikim dhe Informim janë kryer këto aktivitete:

## I. Monitorimi i mediave

- Janë përpiluar 109 raporte ditore të mediave;
- Janë përpiluar 47 raporte javore të mediave;
- Është publikuar Raporti vjetor i mediave për vitin 2019;
- Është bërë arkivimi fizik dhe elektronik i raporteve të mediave të shtypura (139 artikuj) dhe të mediave elektronike (1 258 artikuj) përkitazi me punën e Gjykatës.

## II. Komunikimi me mediat/publikun

- Janë dërguar përgjigjet në 372 pyetje të parashtruara nga mediat e shkruara dhe ato elektronike, si dhe në 288 pyetje/kërkesa të parashtruara nga qytetarët dhe institucionet;
- Janë publikuar 11 njoftime përkitazi me vizitat dhe aktivitetet e Gjykatës;
- Janë publikuar 12 njoftime me informata statistikore përkitazi me seancat dhe vendimet e Gjykatës;
- Janë publikuar 36 njoftime me informata përmbledhëse përkitazi me vendimet e Gjykatës pas seancave shqyrtuese.

## III. Publikimi i fletushkave/broshurave dhe i materialeve të tjera informative

- Është publikuar numri i 9-të dhe i 10-të i Buletinit Informativ të Gjykatës;
- Është publikuar në ueb-faqen e Gjykatës video-animacioni i realizuar me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë: "*Gjykata Kushtetuese dhe parashtrimi i kërkesës*";
- Me përkrahjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, në muajin maj u organizua fushata promovuese tremujore në mediat vendore dhe në rrjetet sociale e video-animacionit: "*Gjykata Kushtetuese dhe parashtrimi i kërkesës*".

#### **IV. Aktivitetet protokollare**

- Janë kryer detyrat protokollare përkitazi me 3 vizita zyrtare në Gjykatë, 2 vizita zyrtare jashtë vendit, 2 punëtori/konferenca të organizuara në vend, 1 punëtori/konferencë të organizuar jashtë vendit, 15 punëtori/konferenca të organizuara nëpërmjet video-konferencës dhe 2 seanca dëgjimore publike;
- Janë përgatitur 15 letër-urime dhe 2 letër-falënderime për udhëheqës institucional vendor e ndërkombëtar.

#### **V. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

- Gjatë vitit 2020 janë pranuar gjithsej 19 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës. Të gjitha kërkesat janë aprovuar nga Gjykata;
- Janë përgatitur 4 raporte tremujore përkitazi me kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës;
- Është përgatitur Raporti vjetor për kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare të Gjykatës për vitin 2019.

#### **VI. Komunikimi me palët/qytetarët**

Gjatë vitit 2020, në recepsionin e Gjykatës janë regjistruar dhe proceduar:

- 308 qytetarë;
- 29 përfaqësues institucionesh.

#### **VII. Bashkëpunimi me Komisionin e Venecias**

- Janë dërguar përgjigjet e Gjykatës në 57 pyetje të parashtruara nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias nga 9 gjykata kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare (*me gjithsej 15 kërkesa*);
- Janë dorëzuar 3 raporte katër-mujore, së bashku me vendimet më të rëndësishme të Gjykatës gjatë kësaj periudhe, për publikim në Buletinet e Komisionit të Venecias;
- Në Forumin e gjykatave kushtetuese dhe supreme të shteteve anëtare të Komisionit të Venecias janë parashtruar 3 kërkesa me pyetje nga Gjykata.

# **AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE**



# AKTIVITETET E GJYKATËS KUSHTETUESE

## I. Udhëtimet zyrtare

### 18 - 20 shkurt 2020

Me ftesë të organizatës amerikane “Federalist Society for Law and Public Policy Studies” dhe si pjesë e delegacionit të rrjetit evropian të gjyqtarëve, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, dhe gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka-Nimani, qëndruan për vizitë pune disaditëshe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

### 19 - 21 shkurt 2020

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, një delegacion i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i përbërë nga Këshilltarja e parë kushtetuese-juridike dhe Drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim, mori pjesë në punëtorinë e hartimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë (2020 – 2023) në Korçë.

## II. Vizitat zyrtare në Gjykatën Kushtetuese/Aktivitete të tjera

### 3 shkurt 2020

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, “*Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese*”, një këshilltar kushtetues-juridik i Gjykatës Kushtetuese qëndroi për vizitë studimore dymujore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

### 2 mars 2020

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ish-gjyqtarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) nga Shqipëria, z. Ledi Bianku, i cili qëndroi për vizitë pune njëjavore në Gjykatë me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë.

### 9 - 10 mars 2020

Në Prishtinë u mbajt punëtorja e radhës përkitazi me Planin e Veprimit të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018 – 2020).

### 16 - 17 prill 2020

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, “*Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese*” dhe me përkrahjen e ekspertëve ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, u mbajt punëtorja e organizuar nëpërmjet video-konferencës, në temën: “*Neni 15 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: Shmangia në rrethana të jashtëzakonshme*”.

## **11 - 12 qershor 2020**

Në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, “*Përmirësimi i Mbrojtjes së Standardeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Gjykata Kushtetuese*” dhe me përkrahjen e ekspertëve ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, u mbajt punëtorja e organizuar nëpërmjet video-konferencës, në temën: “*E drejta në gjykim të paanshëm*”.

## **22 korrik 2020**

Në bashkëpunim me organizatën “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë” (YIHR KS), në kuadër të projektit “Youth for Justice”, këshilltarët kushtetues-juridik të Gjykatës Kushtetuese mbajtën ligjëratë dhe bashkëbisedim me studentë të edicionit të tretë të Shkollës Alternative për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, përkritazi me rolin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese në raport me institucionet e tjera në kuadër të sistemit të drejtësisë në vend.

## **20 - 24 shtator 2020**

Tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e Grupeve Punuese të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018 – 2020) zhvilluan takime konsultative nëpërmjet video-konferencës me ekspertë të angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përkritazi me hartimin e Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2021 – 2023).

## **1 - 2 tetor 2020**

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e Grupeve Punuese të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018 – 2020) zhvilluan takime konsultative nëpërmjet video-konferencës me ekspertë të angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përkritazi me hartimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave të Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2021 – 2023).

## **8 tetor 2020**

Në Gjykatë u mbajt punëtorja e radhës për zbatimin e Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018-2020), për tremujorin e tretë të vitit 2020 dhe planifikimin e aktiviteteve për tremujorin e katërt.

## **16 - 17 tetor 2020**

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën pjesë në Forumin e Shtatë Rajonal për Sundimin e Ligjit për Evropën Juglindore, me temë: “*COVID-19 dhe të drejtat që mbrohen nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut*”, organizuar nëpërmjet video-konferencës nga “Qendra AIRE” dhe organizata "Civil Rights Defenders", me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, të Qeverisë së Suedisë dhe të Fondacionit gjerman "Konrad Adenauer".

## **29 tetor 2020**

Gjyqtarët dhe këshilltarët kushtetues-juridik të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës morën pjesë në Konferencën ndërkombëtare me temë: “*E drejta për gjykim të drejtë dhe Covid-19 - Mësimet e nxjerra dhe Praktikrat më të mira për të ardhmen*”, organizuar

nëpërmjet video-konferencës nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, me rastin e 70-vjetorit të miratimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **3 nëntor 2020**

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e Grupeve Punuese të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018 – 2020) zhvilluan takime konsultative nëpërmjet video-konferencës me ekspertë të angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përkitazi me hartimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave të Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2021 – 2023).

### **12 - 13 nëntor 2020**

Gjyqtarët dhe këshilltarët kushtetues-juridik të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës zhvilluan një takim të organizuar nëpërmjet video-konferencës me ish-Juriskonsultin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, z. Lawrence Early.

### **7 dhjetor 2020**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ambasadorin e ri të Konfederatës së Zvicrës në Kosovë, z. Thomas Kolly.

### **18 dhjetor 2020**

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e Grupeve Punuese të Planit Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2018 – 2020) zhvilluan takime konsultative nëpërmjet video-konferencës me ekspertë të angazhuar nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përkitazi me hartimin e qëllimeve strategjike dhe objektivave të Planit të ri Strategjik të Gjykatës Kushtetuese (2021 – 2023).

### **24 dhjetor 2020**

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ambasadoren e re të Maqedonisë së Veriut në Kosovë, znj. Shpresa Jusufi.





**SHTOJCA I**



## SHTOJCA I

Shën.	2020			2019			2018		
	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit		Pagesat nga palët e treta të jashtme
	BKK	THV		BKK	THV		BKK	THV	
	€	€	€	€	€	€	€	€	
<b>Pranimet</b>									
Ndarjet nga Fondi i përgjithshëm	1,886,805.3			1,957,335.8			1,697,491.74		
Të hyrat vetanake									
Ndarjet nga Fondi me qëllime të dedikuara									
Grantet e përcaktuara të donatorëve									
Fondi i huazimeve									
Pranimet e tjera									
<b>Totali i pranimeve</b>	<b>1,886,805.3</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,957,335.8</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,697,491.74</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Pagesat</b>									
Operacionet									
Pagat dhe mëditjet	2	1,290,540.9		1,288,021.5			1,137,566.66		
Mallrat dhe shërbimet	3	378,504.67		420,473.40			512,153.66		
Shërbimet komunale	4	2,463.72		2,652.28			3,246.63		
		<u>1,671,509.3</u>		<u>1,711,147.26</u>			<u>1,653,296.95</u>		
Transferet									
Transferet dhe subvencionet	5								
Shpenzimet kapitale									
Prona, ndërtesa dhe pajisjet	6								
Kthimi i Huamarrjes	7	215,296.00		246,188.56			44,194.79		
Pagesat e tjera	8								
<b>Pagesat gjithsej</b>		<b>1,886,805.3</b>	<b>-</b>	<b>1,957,335.8</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>1,697,491.74</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Përmbledhje e llogarive të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2020  
Pasqyra e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

## Raporti mbi ekzekutimin e buxhetit

Shënime	2020				2019	2018	
	Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Dallimi	Realizimi	Realizimi	
	A	B	C	D=C-B	E	F	
	€	€	€	€	€	€	
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	9						
Të hyrat jo tatimore	10						
Të hyrat e dedikuara	11						
Grantet dhe ndihma	12						
Huamarrje	13						
Të tjera	14						
<b>Pranimet totale të mbledhura për BKK</b>		-	-	-	-	-	
<b>Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit</b>							
Pagat dhe mëditjet	2	1,172,237	1,290,541	1,290,541	0	1,288,022	1,137,867
Mallrat dhe shërbimet	3	391,117	378,570	378,505	(65)	420,473	512,184
Shërbimet komunale	4	4,000	2,533	2,464	(69)	2,652	3,247
Transferet dhe subvencionet	5						
Shpenzimet kapitale	6	268,000	215,296	215,296	0	246,189	44,195
Fondi i privatizimit	7						
Të tjera	8						
<b>Totali i pagesave i bërë nga BKK</b>		<b>1,835,354</b>	<b>1,886,960</b>	<b>1,886,805</b>	<b>(155)</b>	<b>1,957,336</b>	<b>1,697,491</b>

## Ndarjet e fondit të përgjithshëm për vitin 2020

Klasifikimi ekonomik	2020			2019	2018
	BKK	THV	Totali		
	€	€	€	€	€
Pagat dhe mëditjet	1,290,541		1,290,541	1,288,022	1,137,867
Mallrat dhe shërbimet	378,505		378,505	420,473	512,184
Shërbimet komunale	2,464		2,464	2,652	3,246
Subvencionet dhe transferet					
Shpenzimet kapitale	215,296		215,296	246,189	44,195
	<b>1,886,805</b>	-	<b>1,886,805</b>	<b>1,957,336</b>	<b>1,697,491</b>

# ORGANOGRAMI





REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

# GJYKATA KUSHTETUESE УСТАВНИ СУД CONSTITUTIONAL COURT

